



Adres: Rr. Nëna Terezë Nr 35 10000 Prishtinë

Tel: +381 38 222 859, +377 44 165 040 Email: [bspk@bspk.org](mailto:bspk@bspk.org)

Në mbështetje të nenit 10, pika 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut, nr.2003/13, me ndryshimet dhe plotesimet e Rregullores së UNMIK-ut 2004/45, e duke zbatuar Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-I-16-0268-A0001, dt. 24.08.2017, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK)

### PUBLIKON

**NJOFTIMIN për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) "Rilindja Shtypeshkronja" PRN075 në Prishtinë dhe "Zivko Vasic", GJI027, në Ranillug, KK Kamenicë me qëllim të grumbullimit dhe dorëzimit të dokumentacionit të punëtorëve për këto NSH lidhur me hartimin e listës fillestare në formatin tabelar excel për përfitimin e një pjese prej 20% të të ardhurave nga privatizimi-likuidimi i NSH-ve të theksuara më lartë nga kompetenca e BSPK-së dhe ate:**

1. Librezë e punës (për punëtorët që i posedojnë),
2. Në rast të mungesës të Librezës së punës, çfarëdo dokumenti tjetër (kontrata apo vendime të punës) që dëshmojnë themelimin e marrëdhënies së punës, përkatësisht përfundimin e punësimit në NSH,
3. Vendimin eventual për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për periudhën 1989-1999, gjatë aplikimit të masave të dhunshme diskriminuese nga ish Kuvendi i Republikës së Serbisë (nëse posedojnë këtë vendim),
4. Dokumentet në komunat përkatëse, Dep. për çështje sociale për të rënë në Luftën e Kosovës 1997-1999, qoftë luftetarë të lirisë, por edhe të viktimave civile,
5. Çfarëdo dokumentacioni tjetër i cili dëshmon dhe arsyeton pretendimin për të drejtën e punëtorëve për t'u përfshirë në Listën fillestare në formatin tabelar excel që do të hartohet nga menagjmenti dhe sindikata e NSH përkatëse në bashkëpunim me BSPK-në.
6. Ekstrakti i lindjes dhe kopjet e lejes së njoftimit,
7. Numrat e tel. kontaktues

Të gjitha dokumentet që do të dorëzohen duhet të jenë të noterizuara nga noteri kompetent.

**Dokumentacioni dorëzohet në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, rr. "Qamil Hoxha" nr. 8, 10000 Prishtinë, personalisht dhe përmes postës.**

**Afati për dorëzimin e dokumentacionit të punëtorëve është 30 ditë nga publikimi i njoftimit në mjetet e shkruara të informimit publik.**